



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 33, datë 26. 05. 2022

**“PËR MERATIMIN E VEND DEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE, PËR
BASHKINË SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26. 05. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, Kadastrës, Mjedisit dhe Ujitjes në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të VKM- së Nr. 575, datë 24. 06. 2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", Vendimi Nr.452, datë: 11. 07. 2012, "Për lëndfillin e mbetjeve", i ndryshuar, Ligjit Nr.107, date 31.07.2012, "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit Nr.10431, datë: 09. 06. 2011, "Për mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligjit Nr.10463, datë: 22. 09. 2011, "Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve",

VENDOSI:

1. Vend depozitimi për mbetjet inerte të Bashkisë Skrapar, të jetë në Pasurinë me numër 64, me sipërfaqe totale 48 478 m², zona kadastrale 1420, qyteti Çorovodë, në pronësi – shtet, e cila ndodhet në vendin e njohur me toponimin "Përroi i Pilipizgës", poshtë rrugës, rreth 2 km largë nga qyteti Çorovodë.
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Çorovodë Nr. 64, datë: 16. 12. 1998, "Për vendndodhjen e grumbullimit të mbeturinave të qytetit dhe varrezave të makinave"
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, Kadastrës, Mjedisit dhe Ujitjes
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim – s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

